

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	12 vite pas tragjedisë, Stallone rrefen momentin kur humbi të birin: Nuk ishte njerëzore telefonata që mor a...
ADRESA	https://www.gazetatema.net/lifestyle/12-vite-pas-tragjedise-stallone-rrefen-momentin-kur-humbi-te-birin-nuk-i589170
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 13:30:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 15:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4db8d90268b0ba54c1e7c0cdda1386ef788505105c96306a1a847e8c9fe85205
TEKSTI	ffbed4e1e3d14264aa09152051f4a52f62f5c443a231a0a8e355a411a26131b2
PAMJA	3d36832828d0277292838c1371553f3311afe9c24398b7cce9f1fb1fdde0cb4cf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6288c58e57c69189a31f727b8e5d718a27e7b3c68df97be6de30eada35456783
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4cccf1fa7b0bcd85a4d154c0d42583811e3323ff976f0b5cd4a1ea64b7daae9e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6288c58e57c69189a31f727b8e5d718a27e7b3c68df97be6de30eada35456783>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

VIDEO/ Luksi ne ekstrem, fansi i kerkon Kim Kardashian autograt ne çanten Hermes me viere marramendese "Revolucioni i F'lamingove". Rama: Duas i pelqen protesta, fundit

12 vite pas tragjedisë, Stallone rrëfen momentin kur humbi të birin: Nuk ishte njerëzore telefonata që mora...



29 Shtator 2026, 17:00Lifestyle TEMA



Sylvester Stallone ka folur për dhimbjen e thellë që përjetoi pas humbjes së djalit të tij, Sage, i cili ndërroi jetë në moshën 36-vjeçare nga një atak në zemër.

Në një intervistë për The New York Times, aktori 80-vjeçar kujtoi momentin kur mori lajmin tragjik dhe mënyrën se si kjo humbje ndikoi tek ai.

Stallone tregoi se, edhe pse në ditët e para arriti të përballonte detyrimet dhe ceremoninë mortore, rreth një javë më vonë u përball me një shpërthim të fortë emocional.

"Kaloni nëpër shumë faza faji. Mendon: Çfarë mund të kisha bërë? A duhej të isha aty? Po sikur të kisha bërë këtë? Po sikur të kisha marrë rrugën djathtas në vend të majtas?", rrëfeu ai.

Stallone kujtoi edhe telefonatën përmes së cilës mësoi për vdekjen e të birit. Sipas tij, telefonata ishte e papritur dhe e ftohtë.

"Burri i ri i nënës sime, të cilin nuk e kisha takuar kurrë dhe që ishte mjek, më telefonoi dhe më tha: 'Sly, ai iku. Sage iku'. Unë i thashë: 'Iku ku?'. 'Vdiq. Iku. Më vjen keq'. Dhe e mbylli telefonin", tregoi aktori.

Ditët e para pas humbjes, Stallone mendonte se po arrinte ta përballonte situatën. Por, pasi kaloi ceremonia mortore dhe u përpoq të vazhonte jetën e përditshme, emocionet e mbledhura shpërthyen.

"Me funeralin, duke u kujdesur për nënën e tij dhe duke u përpjekur të vazhdoresh jetën në të tashmen, gjithçka të çon në një botë krejt tjetër. Mendon: 'Uau, po ia dal. Kur do të shpërthej?'. Dhe rreth një javë më vonë, isha krejt vetëm në dhomën time dhe nga brenda meje doli një britmë që nuk e kisha dëgjuar kurrë më parë, as para dhe as pas asaj dite. Ishte thjesht dhimbje, pikëllim dhe faj. Nuk ishte njerëzore", u shpreh ai.

Aktori foli me shumë dashuri për djalin e tij, duke e përshkruar si "një djalë shumë të mirë".

"Ai kishte një nënë të mrekullueshme. Mund të kishte bërë gjëra të mëdha në të ardhmen. Nuk e kisha idenë se kishte diçka që do të prisje të shfaqej tek një njeri shumë më i madh në moshë. Por jo, diçka të tillë nuk e kapërcen", tha Stallone.

Sage Stallone, djali i Sylvester Stallone dhe ish-bashkëshortes së tij Sasha Czack, u gjet i pajetë në shtëpinë e tij në Los Angeles më 13 korrik 2012.

Marrëdhënia mes babait dhe djalit u shfaq edhe në ekranin e madh. Sage luajti rolin e Rocky Balboa Jr., djalit të personazhit të interpretuar nga Sylvester Stallone, në filmin Rocky V.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

14:28 Lifestyle / 1 koment

[Rod Stewart tërhiqet nga muzika pas 60 vitesh karrierë, 81-vjeçari: 'The Final Encore' do të jetë turneu im i fundit](#)

14:04 Lifestyle

Bashkëshortja Jeff Bezos u shfaq me dekolte të theksuar në Shtëpinë e Bardhë, veshja e saj shkakton reagime

13:03 Lifestyle

FOTO/ Rihanna dhe yjet e showbiz-it në Paris, veshjet që morën vëmendjen në Javën e Modës

11:57 Lifestyle

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.